



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës  
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



---

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

# RAPORT I SUKSESIT

PËR GJYSMËVJETORIN E PARË  
TË VITIT SHKOLLOR 2018/19

Janar 2019, Mitrovicë

---

## **HYRJE**

Në vijim është i pasqyruar *Raporti i suksesit për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2018/19*, të përgatitur nga *Drejtoria e Arsimit*, për të gjitha institucionet arsimore, për arsimin parauniversitar, në komunën e Mitrovicës.

Raporti është përmbledhës dhe është i ndarë në këto kategori:

- I. Të dhënat e përgjithshme;
- II. Suksesi i nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2018/19:
  - Kalueshmëria sipas niveleve;
  - Nota mesatare sipas lëndëve mësimore;
  - Mungesat e nxënësve;
  - Braktisja e shkollës nga nxënësit;
  - Riatdhesimi i nxënësve;

## Të dhënat e përgjithshme


Gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2018/19 e kanë ndjekur 16738 nxënës, të grupuar në 878 paralele, të shpërndarë në:

- 1 Institucion Parashkollor (publik) dhe 2 Institucione Parashkollore (private);
- 28 Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta (publike);
- 11 Paralele të Ndara të Shkollave Fillore (publike);
- 1 Shkollë e Mesme e Ulët dhe e Mesme e Lartë (private);
- 5 Shkolla të Mesme të Larta (publike);
- 1 Shkollë për Fëmijë me Nevoja të Veçanta-Qendër Burimore (publike).

Të dhënat e tjera, sipas niveleve shkollore, mund t'i shihni në tabelarin e mëposhtëm:

Grupmosha/Klasa/Niveli	Nr. i grupeve / paraleleve	Numri i nxënësve		
		M	F	GJ
Grupmosha 1-2 vjeç	6	43	25	68
Grupmosha 2-3 vjeç	6	49	34	83
Grupmosha 3-4 vjeç	8	87	72	159
Grupmosha 4-5 vjeç	8	67	73	140
Grupmosha 5-6 vjeç	8	83	71	154
<b>Arsimi Parashkollor (çerdhe) - Gjithsej</b>	<b>36</b>	<b>329</b>	<b>275</b>	<b>604</b>
<b>Arsimi parafillor (Klasa përgatitore) - Gjithsej</b>	<b>41</b>	<b>507</b>	<b>437</b>	<b>944</b>
Klasa 1	77	570	671	1241
Klasa 2	72	621	590	1211
Klasa 3	72	600	563	1163
Klasa 4	75	605	602	1207
Klasa 5	72	575	571	1146
<b>Arsimi Fillor (Klasa 1-5) - Gjithsej</b>	<b>368</b>	<b>2971</b>	<b>2997</b>	<b>5968</b>
Klasa 6	67	578	581	1159
Klasa 7	68	614	594	1208
Klasa 8	69	609	576	1185
Klasa 9	59	636	591	1227
<b>Arsimi i Mesëm i Ulët (Klasa 6-9) - Gjithsej</b>	<b>263</b>	<b>2437</b>	<b>2342</b>	<b>4779</b>
Klasa 10	57	732	754	1486
Klasa 11	58	632	804	1436
Klasa 12	55	727	794	1521
<b>Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasa 10-12) -Gjithsej</b>	<b>170</b>	<b>2091</b>	<b>2352</b>	<b>4443</b>
<b>Gjithsej nxënës</b>	<b>878</b>	<b>8335</b>	<b>8403</b>	<b>16738</b>

Nga tabela paraprake shihet se numri më i madh i nxënësve është në arsimin fillor, ndërsa numri më i vogël i nxënësve është në arsimin parashkollor. Përfshirja e nxënësve nëpër nivele shkollore është e paraqitur në grafikonin e mëposhtëm:



### Kalueshmëria sipas niveleve shkollore në gjysmëvjetorin e parë 2018/19


Në fund të gjysmëvjetorit të parë 2018/19, kalueshmëria e nxënësve në nivel komune, për të gjitha nivelet arsimore, e shprehur në përqindje është 73.81%. Në raport me vitin e kaluar (73.25%) është përqindje pothuajse e njëjtë, 0.56 % më e lartë. Si zakonisht, kalueshmëri më të lartë ka treguar niveli *Fillor* (klasa 1-5) me 99.23%, pastaj niveli i *Mesëm i Ulët* (Klasa 6-9) me 75.08% dhe niveli i *Mesëm i Lartë* (10-12) me 38.28 %.

Klasa	Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej pozitiv	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasa 1	1075	86.62	112	9.02	39	3.14	12	0.97	1238	99.76
Klasa 2	829	68.46	221	18.25	109	9	48	3.96	1207	99.67
Klasa 3	745	64.06	235	20.21	123	10.58	44	3.78	1147	98.62
Klasa 4	720	59.65	278	23.03	151	12.51	43	3.56	1192	98.76
Klasa 5	675	58.9	240	20.94	165	14.4	58	5.06	1138	99.30
<b>Gjithsej 1-5</b>	<b>4044</b>	<b>67.76</b>	<b>1086</b>	<b>18.2</b>	<b>587</b>	<b>9.84</b>	<b>205</b>	<b>3.43</b>	<b>5922</b>	<b>99.23</b>
Klasa 6	359	30.97	333	28.73	231	19.93	43	3.71	966	83.35
Klasa 7	309	25.58	284	23.51	263	21.77	72	5.96	928	76.82
Klasa 8	311	26.24	259	21.86	239	20.17	51	4.3	860	72.57
Klasa 9	364	29.67	215	17.52	198	16.14	57	4.65	834	67.97
<b>Gjithsej 6-9</b>	<b>1343</b>	<b>28.1</b>	<b>1091</b>	<b>22.83</b>	<b>931</b>	<b>19.48</b>	<b>223</b>	<b>4.67</b>	<b>3588</b>	<b>75.08</b>
Klasa 10	169	11.37	216	14.54	128	8.61	19	1.28	532	35.80
Klasa 11	228	15.88	221	15.39	161	11.21	15	1.04	625	43.52
Klasa 12	199	13.08	198	13.02	126	8.28	21	1.38	544	35.77
<b>Gjithsej 10-12</b>	<b>596</b>	<b>13.41</b>	<b>635</b>	<b>14.29</b>	<b>415</b>	<b>9.34</b>	<b>55</b>	<b>1.24</b>	<b>1701</b>	<b>38.28</b>
<b>Gjithsej 1-12</b>	<b>5983</b>	<b>39.39</b>	<b>2812</b>	<b>18.51</b>	<b>1933</b>	<b>12.73</b>	<b>483</b>	<b>3.18</b>	<b>11211</b>	<b>73.81</b>

Nga pasqyrimet e mësipërme tabelare, vërehet se brenda nivelit Fillor (Klasa 1-5), kalueshmëri më të lartë kanë treguar klasat e para, me 99.76%. Në nivelin e Mesëm të Ulët (Klasa 6-9, përqindja e kalueshmërisë është më e lartë te klasat e gjashta, 83.35%. Në nivelin e Mesëm të Lartë (Klasa 10-12), dominon përqindja e kalueshmërisë te klasat e njëmbëdhjeta, me 43.52%. Në suksesin pozitiv dominon përqindja e nxënësve që kanë treguar sukses të shkëlqyeshëm (5983 nxënës), me 39.39%. Pas suksesit të shkëlqyeshëm, përqindje më të lartë ka te sukseksi i shumë mirë (2812 nxënës), me 18.51%.

Sa i përket suksesit negativ, në gjysmëvjetorin parë të vitit shkollor 2018/19 për nivelin Fillor (Klasa 1-5), përqindja e nxënësve që kanë sukses negativ është 0.77%. Në nivelin e Mesëm të Ulët (Klasa 6-9) kjo përqindje është 24.92% dhe në nivelin e Mesëm të Lartë (Klasa 10-12) përqindja është 61.72%. Nga pasqyrimet tabelare, vërehet se brenda nivelit Fillor (Klasa 1-5) sukses negativ me përqindje më të lartë kanë klasat e treta, me 1.38%. Te niveli i Mesëm i Ulët (Klasa 6-9), kjo përqindje është më e lartë te klasat e nënta, me 32.03%. Në nivelin e Mesëm të Lartë (Klasa 10-12), dominon përqindja te klasat e dymbëdhjeta, me 64.23%.

Klasa	Me një notë të dobët		Me dy nota të dobëta		Me tri e më shumë nota të dobëta		Të pa notuar		Gjithsej negativ	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasa 1	2	0.16	0	0	0	0	1	0.08	3	0.24
Klasa 2	0	0	0	0	0	0	4	0.33	4	0.33
Klasa 3	4	0.34	4	0.34	7	0.6	1	0.09	16	1.38
Klasa 4	7	0.58	1	0.08	5	0.41	2	0.17	15	1.24
Klasa 5	1	0.09	0	0	7	0.61	0	0	8	0.70
<b>Gjithsej 1-5</b>	<b>14</b>	<b>0.23</b>	<b>5</b>	<b>0.08</b>	<b>19</b>	<b>0.32</b>	<b>8</b>	<b>0.13</b>	<b>46</b>	<b>0.77</b>
Klasa 6	51	4.4	55	4.75	86	7.42	1	0.09	193	16.65
Klasa 7	92	7.62	64	5.3	122	10.1	2	0.17	280	23.18
Klasa 8	97	8.19	99	8.35	127	10.72	2	0.17	325	27.43
Klasa 9	106	8.64	131	10.68	152	12.39	4	0.33	393	32.03
<b>Gjithsej 6-9</b>	<b>346</b>	<b>7.24</b>	<b>349</b>	<b>7.3</b>	<b>487</b>	<b>10.19</b>	<b>9</b>	<b>0.19</b>	<b>1191</b>	<b>24.92</b>
Klasa 10	176	11.84	120	8.08	657	44.21	1	0.07	954	64.20
Klasa 11	127	8.84	104	7.24	576	40.11	4	0.28	811	56.48
Klasa 12	181	11.9	151	9.93	636	41.81	9	0.59	977	64.23
<b>Gjithsej 10-12</b>	<b>484</b>	<b>10.89</b>	<b>375</b>	<b>8.44</b>	<b>1869</b>	<b>42.07</b>	<b>14</b>	<b>0.32</b>	<b>2742</b>	<b>61.72</b>
<b>Gjithsej 1-12</b>	<b>844</b>	<b>5.56</b>	<b>729</b>	<b>4.8</b>	<b>2375</b>	<b>15.64</b>	<b>31</b>	<b>0.2</b>	<b>3979</b>	<b>26.19</b>




### Nota mesatare sipas lëndëve mësimore në nivelin *Fillor* dhe të *Mesëm të Ulët*

Duke ju referuar të dhënave në tabelën e pasqyimit të notave mesatare, vërehet se në nivelin *Fillor* dhe të *Mesëm të Ulët* (Klasa 1-9), nota mesatare më e lartë është në lëndën *Gjuhë turke* 4.65, ndërsa nota mesatare më e ulët është në lëndën e *Kimisë*, 3.31. Mesatarja më e lartë e përgjithshme e klasave është te klasat e para (4.74), kurse mesatarja më e ulët është te klasat e shtata, 3.61. Detajet për secilen klasë dhe lëndë mund t'i shihni në tabelën në vijim:

Klasa	Art figurativ	Biologji	Edukatë fizike dhe sportive	Edukatë muzikore	Edukatë qytetare	Edukim shëndëtsor	Fizikë	Gjeografi	Gjuhë angleze	Gjuhë boshnjake	Gjuhë gjermane	Gjuhë shqipe	Gjuhë turke	Histori	Jeta dhe puna	Kimi	Matematikë	Ndërmarrësia	Njeriu dhe natyra	Punëdore	TIK	Të tjera...
Klasa 1	4.89		4.91	4.88	4.80	4.82			4.72	4.00		4.63			4.84		4.67		4.79	4.84		4.83
Klasa 2	4.66		4.79	4.63	4.47	4.05			4.38	0.00		4.36	5.00		4.59		4.37		4.41	4.82		4.46
Klasa 3	4.65		4.78	4.64	4.36	4.72			4.20	5.00		4.27	4.75		4.38		4.24		4.23	4.59		4.30
Klasa 4	4.66		4.79	4.61	4.23	5.00			4.04	5.00		4.22			4.56		4.14		4.18	4.44		4.30
Klasa 5	4.57		4.77	4.49	4.11	4.17			3.96	4.00		4.18	4.50	4.21	4.27		4.11		4.08	4.48		4.34
Klasa 6	4.06	3.56	4.44	3.91	3.63	5.00	3.47	3.68	3.65	2.50	3.92	3.74		3.76	3.79		3.58	4.08	3.33		3.88	4.03
Klasa 7	4.05	3.41	4.38	3.79	3.54		3.32	3.49	3.52	3.00	3.61	3.44	4.00	3.50	3.37	3.39	3.31		3.76		3.74	3.96
Klasa 8	3.92	3.40	4.44	3.80	3.57		3.38	3.54	3.63	5.00	3.55	3.45	5.00	3.50		3.24	3.23	3.43			3.74	3.90
Klasa 9	3.94	3.44	4.28	3.74	3.58		3.37	3.57	3.57	4.00	3.65	3.54		3.54		3.31	3.24	3.32			3.72	3.90
Gjithsej	4.38	3.45	4.62	4.28	4.03	4.63	3.39	3.57	3.96	3.61	3.68	3.98	4.65	3.70	4.26	3.31	3.88	3.61	4.11	4.63	3.77	4.22

### Diagrami i notës mesatare sipas lëndëve mësimore në nivelin *Fillor* dhe të *Mesëm të Ulët*



## Mungesat e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2018/19

Nga tabela e mungesave, sipas klasave dhe niveleve shkollore, vërehet se numri i përgjithshëm i mungesave (Të arsyeshme 6.85 mungesa për kokë nxënësi; Të paarsyeshme 3.90 mungesa për kokë nxënësi) në nivel komune është 10.76 mungesa për kokë nxënësi.

Numri më i vogël i mungesave të përgjithshme (Të arsyeshme 3.56 mungesa për kokë nxënësi; Të paarsyeshme 0.51 mungesa për kokë nxënësi) është në

Klasa	Numri i mungesave			Raporti i mungesave për kokë nxënësi		
	Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej	Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
Klasa 1	3900	337	4237	3.14	0.27	3.41
Klasa 2	4166	477	4643	3.44	0.39	3.83
Klasa 3	3621	566	4187	3.11	0.49	3.60
Klasa 4	5049	1049	6098	4.18	0.87	5.05
Klasa 5	4499	640	5139	3.93	0.56	4.48
<b>Gjithsej 1-5</b>	<b>21235</b>	<b>3069</b>	<b>24304</b>	<b>3.56</b>	<b>0.51</b>	<b>4.07</b>
Klasa 6	7836	1180	9016	6.76	1.02	7.78
Klasa 7	9213	1701	10914	7.63	1.41	9.03
Klasa 8	10566	3480	14046	8.92	2.94	11.85
Klasa 9	10203	4708	14911	8.32	3.84	12.15
<b>Gjithsej 6-9</b>	<b>37818</b>	<b>11069</b>	<b>48887</b>	<b>7.91</b>	<b>2.32</b>	<b>10.23</b>
Klasa 10	12021	14368	26389	8.09	9.67	17.76
Klasa 11	13633	11048	24681	9.49	7.69	17.19
Klasa 12	19402	19707	39109	12.76	12.96	25.71
<b>Gjithsej 10-12</b>	<b>45056</b>	<b>45123</b>	<b>90179</b>	<b>10.14</b>	<b>10.16</b>	<b>20.30</b>
Gjithsej 1-12	104109	59261	163370	6.85	3.90	10.76

nivelin Fillor (Klasa 1-5), me 4.07 mungesa për kokë nxënësi. Në nivelin e Mesëm të Ulët (Klasa 6-9), numri i mungesave të përgjithshme (Të arsyeshme 7.91 mungesa për kokë nxënësi; Të paarsyeshme 2.32 mungesa për kokë nxënësi) është 10.23 mungesa për kokë nxënësi. Në nivelin e Mesëm të Lartë (Klasa 10-12) numri i mungesave të përgjithshme (Të arsyeshme 10.14 mungesa për kokë nxënësi; Të paarsyeshme 10.16 mungesa për kokë nxënësi) është 20.30 mungesa për kokë nxënësi që është numër më i madh në raport me të dy nivelet e tjera shkollore.

Në nivelin Fillor, numër më të vogël të mungesave të përgjithshme kanë nxënësit e klasave të para, më pak se katër mungesa për kokë nxënësi (3.41). Mungesa të paarsyeshme ka më së paku në klasën e parë (0.27 mungesa për kokë nxënësi, pra më pak se gjysmë mungese). Numër më të madh të mungesave (të arsyeshme edhe të paarsyeshme) ka në nivelin e Mesëm të Lartë dhe atë më së shumti në klasat e dymbëdhjeta (12.76 mungesa të arsyeshme për kokë nxënësi dhe 12.96 mungesa të paarsyeshme për kokë nxënësi).

## Braktisja e shkollës në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2018/19

Gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2018/19, shkollën e kanë braktisur 9 nxënës (3 M dhe 6 F). Prej tyre, 1 nxënës në klasën e parë, 4 nxënës në klasën e njëmbëdhjetë dhe 4 nxënës në klasën dymbëdhjetë). Nga tabela e paraqitur më poshtë, po vërehet se përqindja e braktisjes është 0.054 (M=0.036; F=0.071).

Klasa	Braktisën shkollën			% e braktisjes		
	Mashkull	Femër	Total	Mashkull	Femër	Total
Klasa 1	0	1	1	0,000	0,149	0.081
Klasa 11	1	3	4	0,154	0,373	0.275
Klasa 12	2	2	4	0,270	0,251	0.26
<b>Totali</b>	<b>3</b>	<b>6</b>	<b>9</b>	<b>0.036</b>	<b>0.071</b>	<b>0.054</b>

Në nivelin Fillor të Mesëm të Ulët është 1 nxënës që e ka braktisur shkollën. Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM) në nivel shkolle dhe në nivel komune është duke bërë përpjekje që këtë nxënës ta ikthej në shkollë. Gjatë këtij gjysmëvjetori këto ekipe i kanë kthyer 3 raste në shkolla dhe janë duke e vijuar mësimin e rregullt.

Braktisja në nivelin e mesëm të lartë kryesisht ndodhë në shkollat profesionale, ku disa nxënës fillojnë të punojnë, disa nga vajzat martohen, disa shkojnë jashtë vendit, etj. Në braktisje ndikojnë edhe faktorë të tjerë, si rastet e fëmijëve që kanë probleme të natyrave të ndryshme familjare, sociale, etj.

Në të gjitha shkollat funksionojnë Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit. I njëjti ekip funksionon edhe në kuadër të komunës. Këto ekipe së bashku edhe me organet e tjera të shkollës ekskluzivisht merren me trajtimin e këtyre rasteve. Realizojnë vizita të vazhdueshme te familjet e këtyre nxënësve që e kanë braktisur shkollën dhe i shqyrtojnë të gjitha mundësitë për t'i kthyer në shkollë. Deri tani kanë arritur që disa raste t'i kthejnë në shkollë. Në këtë drejtim bashkëpunojnë me policinë, me komunitetin, me qendrën për punë sociale, OJQ-të, etj. MASHT-i në bashkëpunim me UNICEFIN kanë krijuar një modul të ri në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) që ka të bëjë me Sistemin për Parandalimin e Hershëm të Braktisjes, ku të gjitha shkollat janë të obliguara që të raportojnë në këtë sistem parandalues dhe t'i marrin të gjithë hapat e nevojshëm parandalues në bashkëpunim me të gjithë akterët e tjerë.



## Riatdhesimi i nxënësve në gjysmëvjetorin e parë 2018/19

Në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2018/19 janë riatdhesuar gjithsej 25 nxënës (10 M dhe 15 F).

Në nivelin fillor janë riatdhesuar 11 nxënës (4 M dhe 7 F).

Në nivelin e mesëm të ulët janë riatdhesuar 13 nxënës (6 M dhe 7 F).

Në nivelin e mesëm të lartë është riatdhesuar 1 nxënës.

Klasa	Mashkull	Femër	Gjithsej
Parafillor	0	1	1
Klasa 1	0	1	1
Klasa 2	2	2	4
Klasa 3	0	3	3
Klasa 4	1	0	1
Klasa 5	1	0	1
Klasa 6	2	2	4
Klasa 7	0	2	2
Klasa 8	2	2	4
Klasa 9	2	1	3
Klasa 10	0	1	1
<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>	<b>15</b>	<b>25</b>

Pra, më shumti nxënës janë riatdhesuar në nivelin e mesëm të ulët (klasa 6-9). Këta nxënës e kanë filluar mësimin menjëherë, pa e humbur asnjë ditë dhe i kanë vazhduar procedurat e nevojshme për nostrifikim të dokumentacioneve. Për këta nxënës, në bashkëpunim me MASHT-in janë organizuar dhe do të organizohen në vazhdimësi kurse për gjuhë, kuptohet për ata që kanë vështirësi në gjuhën shqipe dhe që kanë migruar më herët.